



Inspektorati Shtetëror i Punës
dhe Shërbimeve Shoqërore

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur ndërmjet

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

DHE

INSPEKTORIATIT SHTETËROR TË PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE


PËR

KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI

PËR

INSPEKTORIATIN SHTETËROR TË PUNËS
DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Robert GAJDA



Arben SEFERAJ

KRYEINSPEKTOR



154 Prot.

Dt. 23.01.2019.

Prot. № 118

Dt. 23.01.2019

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur ndërmjet

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

DHE

INSPEKTORIATIT SHTETËROR TË PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Në vazhdim të referuara si “Palë”,

Duke dëshiruar që të zhvillojnë marrëdhëniet ndërmjet dy institucioneve, me synimin për të siguruar të drejtën e e çdo personi për: brarazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat e për të gëzuar liritë, për mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, në fushën e veprimtarisë të cilën ato mbulojnë, kanë arritur mirëkuptimin si më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj marrëveshje është institucionalizimi i marrëdhënieve midis palëve për sigurimin e ndihmës reciproke në drejtim të lehtësimit të shkëmbimit të informacionit e bashkëpunimit midis dy institucioneve, në kuadër të marrjes së masave për mbrojtjen nga diskriminimi në punësim, dhe fushën e shërbimeve shoqërore.

Neni 2 Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj marrëveshje është ligji nr.10221, datë 04.02.2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", ligji nr. 10433, datë 16.6.2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", ligji nr. 9634, datë 30.10.2006 "*Për inspektimin e punës*", ligj nr. 121/2016 "*Për shërbimet e*



shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 3

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit

3.1 Palët do të bashkëpunojnë për marrjen e masave për promovimin e parimit të barazisë dhe mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e punësimit, bashkëpunim i cili konsiston në :

3.1.1 shkëmbimin e kuadrit ligjor bazë dhe të dhënave të tjera lidhur me garantimin e të drejtës për punësim dhe profesion të çdo personi, dhe anëtarësimin në organizatat sindikale;

3.1.2.shkëmbim ekspertize për përmirësimin e legjislacionit të punës, me synim shtimin e masave për mbrojtjen nga diskriminimi, në punësim dhe profesion;

3.1.3.shkëmbim ekspertize dhe organizim aktivitetesh për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen nga diskriminimi në punësim, sipas përcaktimeve të kreut II të ligjit nr.10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;

3.1.4. shkëmbim informacioni, lidhur me ankesat e paraqitura ne Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ndjekjen e tyre, për diskriminimin në fushën e punësimit.

3.1.5 inspektime të përbashkëta, në raste të caktuara me miratimin e përbashkët të titullarëve të të dy institucioneve, me qëllim kontrollin e përmbushjes së detyrimeve për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e punësimit si dhe në raste të caktuara në kuadër të shqyrtimit të ankesave nga ana e Komisionerit.

3.2 Palët do të bashkëpunojnë edhe në forma të tjera të bashkëpunimit për të cilat mund të bihet dakort në të ardhmen.

Neni 4

Mbrojtja nga diskriminimi e personave të huaj të punësuar/vetëpunësuar në Shqipëri

4.1 Palët do të bashkëpunojnë për marrjen e masave për mbrojtjen nga diskriminimi të personave të huaj të punësuar/vetëpunësuar në Shqipëri, bashkëpunim i cili konsiston në :

4.1.1 shkëmbimin e kuadrit ligjor bazë dhe të dhënave të tjera lidhur me trajtimin e barabartë dhe mbrojtjen e të drejtave të personave të huaj të punësuar/vetëpunësuar në Shqipëri;

4.1.2 shkëmbim ekspertize për përmirësimin e legjislacionit me qëllim garantimin e të drejtave dhe detyrimeve të personave të huaj të punësuar/vetëpunësuar në Shqipëri;

4.1.3. shkëmbim informacioni, lidhur me ankesat e paraqitura ne Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ndjekjen e tyre, për diskriminimin e personave të huaj të punësuar/vetëpunësuar në Shqipëri.

4.1.4 inspektive të përbashkëta, në raste të caktuara me miratimin e përbashkët të titullarëve të të dy institucioneve, me qëllim kontrollin e përmbushjes së detyrimeve për mbrojtjen nga diskriminimi të personave të huaj të punësuar/vetëpunësuar si dhe në raste të caktuara në kuadër të shqyrtimit të ankesave nga këta persona, nga ana e Komisionerit.

4.2 Palët do të bashkëpunojnë edhe në forma të tjera të bashkëpunimit për të cilat mund të bihet dakort në të ardhmen.

Neni 5

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e shërbimeve shoqërore

5.1 Palët do të bashkëpunojnë për marrjen e masave për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e shërbimeve shoqërore, bashkëpunim i cili konsiston në:

5.1.1. shkëmbimin e kuadrit ligjor bazë dhe të dhënave të tjera lidhur me kontributin dhe mundësinë për të përfituar nga shërbimet shoqërore, me qëllim përmirësimin e legjislacionit në këtë fushë;

5.1.2. shkëmbimin e ekspertizës mbi organizimin dhe administrimin e praktikave që ndiqen për sistemin e shërbimeve shoqërore, lidhur me grupet në nevojë;

5.1.3 organizim aktivitetesh për sensibilizim dhe ndërgjegjësim për përfitimet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas përcaktimeve të nenit 8 të Ligjit 121/2016 datë 24.11.2016 "*Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë*".

5.1.4. shkëmbim informacioni, lidhur me ankesat e paraqitura ne Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ndjekjen e tyre, për diskriminimin për përfitim nga shërbimet shoqërore që ofrohen sipas legjislacionit në fuqi.

5.1.5 inspektive të përbashkëta, në raste të caktuara, me miratimin e përbashkët të titullarëve të të dy institucioneve, me qëllim kontrollin e përmbushjes së detyrimeve për mbrojtjen nga



diskriminimi në fushën e ofrimit të shërbimeve shoqërore si dhe në raste të caktuara në kuadër të shqyrtimit të ankesave nga ana e Komisionerit.

5.2 Palët do të bashkëpunojnë edhe në forma të tjera të bashkëpunimit për të cilat mund të bihet dakort në të ardhmen.

Neni 6

Komunikimi i palëve

- 6.1 Palët në zbatim të kësaj marrëveshje do të caktojnë nga një person kontakti.
- 6.2 Personat e kontaktit do të mbajnë vazhdimisht takime ndërmjet tyre, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni, si dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.
- 6.3 Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore ose me e-mail, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit.
- 6.4 Palët do të njoftojnë menjëherë në rast se ndryshohet personi i kontaktit.
- 6.5 Në dhe për zbatim të kësaj marrëveshje, personat e kontaktit do të jenë:
- a. Për KMD-në _____
 - b. Për ISHPSHSH-në _____

Neni 8

Mirëbesimi

- 8.1 Palët do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
- 8.2 Palët duhet të mbajnë në mirëbesim të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë marrëveshje dhe të zbatohet çdo detyrim që rrjedh nga legjislacioni që lidhet me dokumentacionin e administruar respektivisht.

Neni 9

Marrëveshja dhe ndryshimet

- 9.1 Palët marrin përsipër respektimin dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.
- 9.2 Marrëveshja mund të ndryshohet, të amendohet në çdo kohë, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë të paraqitur me shkrim.
- 9.3 Çdo shtesë a ndryshim i saj do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të fillojë efekte juridike vetëm pas nënshkrimit nga palët.
- 9.4 Asnjë amendament ose ndryshim tjetër i marrëveshjes nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me





shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht marrëveshjes dhe të nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i palëve.

Neni 10 Dispozitat e fundit

- 10.1 Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zbatohet me afat të pacaktuar. Në rast ndryshimi të kushteve që kanë diktuar nënshkrimin e saj, palët do të paraqesin dhe miratojnë ndryshimet përkatëse të kësaj marrëveshjeje.
- 10.2 Kjo Marrëveshje lidhet pa afat të caktuar.
- 10.3 Çdo palë mund të kërkojë zgjidhjen e marrëveshjes, duke njoftuar palën tjetër 30 ditë para.
- 10.4 Në rast mosmarrëveshje të dyja palët i zgjidhin ato nëpërmjet negocimit dhe me mirëkuptim.
- 10.5 Marrëveshja përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale, 2 (dy) prej të cilave depozitohen pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe 2 (dy) të tjera pranë Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

PËR

KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI



PËR

INSPEKTORIATIN SHTETËROR TË PUNËS
DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE

